




Pranimar / Dorezuar Priljena / Prodato Received / Delivery		23.12.2020	0	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHTICK	3276/2020		113	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr. 355/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi – Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj dhe Eshref Shabani - anëtar, Arditra Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.355/2020, të datës 13.11.2020, të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adrese Rruga „Muharrem Fejza” p.n, Ndërtesa e MTI-se, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen juridike “kompenzim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 23.12.2020, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.355/2020 e datës 13.11.2020, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED]**

**A r s y e t i m**

Ankuesit [REDACTED], i punësuar sipas akt emërimit të datës 17.03.2010, në pozitën “Zyrtar për mbështetjen e bizneseve fillestare” në Agjencinë për mbështetjen e NVM-ve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me datën 25.02.2019 i ‘u është bere ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit në pozitën “Zyrtar për cilësinë e naftës dhe produkteve të naftës” në Departamentin e Rezervave Shtetërore të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, sipas vendimit për transfer me numër Nr.2083 të datës 03.12.2018, me koeficient shtate (7).

Me datën 02.09.2020, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë ka nxjerr vendimin me numër Nr.Prot.5837, me të cilin e ka aprovuar kërkesën e z. [REDACTED]-Zyrtar i lartë për cilësi të naftës dhe produkteve të naftës (DRSHM) si dhe ka kërkuar të behet harmonizimi i koeficientit sipas akt emërimit nga shtate (7) në tete (8), sipas katalogut dhe përshkrimit të vendeve të punës.

Me datën 04.11.2020, zëvendës Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ka nxjerr vendimin me numër Nr.Prot.8261, me të cilin e ka pezulluar vendimin me numër Nr.5837 për harmonizimin e akt emërimit sipas koeficientit nga shtate (7) në tete (8), sipas katalogut dhe përshkrimit të vendeve të punës.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër Nr.Prot.8261 të datës 12.11.2020 ka parashtruar ankesë me datën 13.11.2020, përmes e-mailit zyrtar [ankesa.kpmshtck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshtck@rks-gov.net), e cila është regjistruar po me këtë

date me numër të protokollit 2569/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor harmonizimin e pagës nga koeficienti shtatë (7) në tetë (8).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 19.11.2020 me numër protokollit 2645/2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankese tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ndërsa me datën 27.11.2020 me numër protokollit 2808/2020, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankese nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me shkresat e bashkangjitura .

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër A nr.355/2020, e datës 13.11.2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i datës 04.11.2020 i Ud. Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Vendim i datës 02.09.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Formulari i shpenzimit të Departamentit-Divizionit ose Sektorit; E-maili zyrtar i datës 04.11.2020; E-maili zyrtar i datës 23.09.2020; E-maili zyrtar i datës 20.08.2020; E-maili zyrtar i datës 19.08.2020; E-maili zyrtar i datës 17.06.2020; E-maili zyrtar i datës 12.06.2020; E-maili zyrtar i datës 04.11.2019; E-maili zyrtar i datës 31.10.2019; Kërkesa për përgjigje në ankese e datës 19.11.2020; Përgjigje në ankese e datës 27.11.2020; Kontrata e marrëdhënies së punës së ankuesit e datës 17.03.2010; Akt emërimi i ankuesit i datës 02.02.2012 ; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit i datës 25.02.2019 i ankuesit; Vendim i datës 02.09.2020; Vendim i datës 04.11.2020; Kërkesë sipas qarkores buxhetore 2021/02 e datës 29.09.2020; Kërkesat shtese sipas qarkores buxhetore për vitet 2021-2023.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit Ermal Kutllovci, **është e pa bazuar sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me harmonizimin e koeficientit nga koeficienti shtatë (7), në koeficient tetë (8), dhe ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara në ligj, sepse në baze të dëshmive të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit ankuesi është punësuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë përmes procedurës së rekrutimit respektivisht përmes konkursit të jashtëm të shpallur datën 10.02.2010, në gazetën Kosova sot për pozitën e lirë të punës „Zyrtar për mbështetje të bizneseve fillestare”, në Agjencinë për mbështetjen e Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me koeficient shtatë (7).

Kolegji për shqyrtimin e ankesave po ashtu ka konstatuar se pas përfundimit të procedurës së rekrutimit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë i ka ofruar ankuesit Aktin e emërimit për nënshkrim me kushtet e punësimit për këtë pozitë, ku njëra ndër kushtet ka qenë edhe koeficienti 7, të cilin Akt Emërimi ankuesi e ka nënshkruar me datë 17.03.2010 për pozitën „Zyrtar për mbështetje të bizneseve fillestare” në Agjencinë për mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme me koeficient shtatë (7), ndërsa me datën 25.02.2019 ankuesit i ‘u është bere ndryshimi dhe plotësimi i Aktit të emërimit në pozitën “Zyrtar për cilësinë e naftës dhe produkteve të naftës” në Departamentin e Rezervave Shtetërore të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, sipas vendimit për transfer me numër Nr.2083 të datës 03.12.2018, me koeficient shtatë (7). Andaj, duke u bazuar në faktet e lartëcekura, Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë lidhur me kompensimin e pagës së ankuesit me koeficient (7), ka vepruar në pajtim me nenin 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësive Civil, ku përcaktohet se: **“Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kontratës së punës”**, respektivisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka qenë e obliguar që të bëjë kompensimin e pagës sipas Akt Emërimit pa afat të datës 17.03.2010 dhe ndryshimit dhe plotësimit të Aktit të emërimit, të datës 25.02.2019 ku është paraparë që ankuesi t’a realizoj të drejtën e pagës sipas koeficientit shtatë (7).

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për harmonizimin e koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8) sipas vendimit nr.5837 të datës 02.09.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave gjatë shqyrtimit të lëndës ka konstatuar se Sekretari i

Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, përmes Vendimit nr. 5837 të datës 02.09.2020 ka aprovuar kërkesën e ankuesit për harmonizim të koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8), mirëpo me datë 04.11.2020 përmes vendimit me numër të protokollit 8261, ka pezulluar zbatimin e vendimit nr. 5837 me arsyetimin se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë nuk ka buxhet për harmonizimin e koeficientit të pagës. Andaj, duke marr parasysh se vendimi i lartcekur i organit të punësimit, në mungesë të buxhetit është pezulluar, Kolegji për shqyrtimin e ankesave vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave në bazë të mandatit kushtetues dhe ligjor, për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve dhe veprimeve të organeve të administratës, konstaton se avancimi në karrierë në shërbimin civil duhet të bëhet në mënyrë transparente, të drejtë, të unifikuar, objektive dhe në bazë të meritës së kandidatëve përkatës. Nëpunësit civil ngritën në pozitë në bazë të një procedure të rregulluar dhe vetëm nëse i plotësojnë kushtet specifike të përcaktuara në aktet përkatëse ligjore dhe në bazë të meritës, prandaj ngritja në pozitë nuk bëhet në mënyrë automatike, por vetëm pas një periudhe të caktuar kohore. Ngritja në pozitë mbi kritere të tjera që nuk bazohen në parimin e meritës është e ndaluar, andaj institucionet me rastin e ngritjes së koeficientit, duhet të respektojnë dispozitat ligjore, rregullat dhe parimet sipas legjislacionit në fuqi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

***Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda Nr. A.nr.355/2020***

**Ardita Perçuku-Shyti**

**Procesmbajtëse**

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

**Kryetare e Kolegjit**

***Vendimi i dërgohet:***

- Ankuesit [REDAKTUAR];
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë ;
- Arkivit të KPMSHCK-së

